



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Vendimi Nr. K-04/25
Data: 09.01.2025

Në mbështetje të nenit 68 dhe 70 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenit 11, nenit 28, nenit 29, nenit 33, nenit 34, nenit 54 paragrafi 2, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Nenin 6, të Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në kërkesën e datës, 28.02.2022 me Nr. Prot. 71/22-01/H nga "Zyra e Rregullatorit për Energji" lidhur me ngritjen e shqetësimeve për shtrembërim të Konkurrencës,

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit të datës 05.12.2024, me nr.prot: 772/24-09-H për hetimin ndaj Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A. për abuzim me pozitën dominuese, në mbledhjen e mbajtur me datën 09.01.2025 merr këtë:

V E N D I M

- I.** Me të cilin konstatohet se Ndërmarrja Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., me NUI: 811280015 me adresë: Prishtinë, 13, Sheshi Bill Klinton, bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga viti 2021 deri në vitin 2023, ka pasur pozitë dominuese në prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike;
- II.** Me të cilin: konstatohet se Ndërmarrja Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., nga viti 2021 deri në vitin 2023, ka abuzuar me pozitën dominuese e cila bie ndesh me Nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.5. të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- III.** Ndërmarrjes Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., i shqiptohet masa ndëshkuese administrative në shumën prej **40,849.22 €**, me shkronja (*Dyzet mijë e tetëqind e dyzet e nëntë euro e njëzetë e dy centë*), të totalit të të hyrave në tregun përkatës;
- IV.** Mjetet nga masa ndëshkuese administrative, të transferohen në llogarinë bankare të buxhetit të Republikës së Kosovës, sipas afatit ligjor pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
- V.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

ARSYETIM

Autoriteti i Konkurrencës, me datë 28.02.2022 ka pranuar kërkesën, me Nr. protokoll: 71/22-01/H, nga Zyra e Regullatorit të Energjisë, me seli në Prishtinë.

ZRRE ka kërkuar nga AKRK që të vlerësojë çështjet e konkurrencës, përkitazi me Kontratën: 012986, të datës 21.12.2020, e lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A. (HC Ujmani) dhe Ndërmarrjes "Future Energy Trading and Exchange Dynamics" SH.P.K., pasi që kjo kontratë pretendohet, se shkelë rregullat e tregut të energjisë, në Republikën e Kosovës, sipas nenit 22 dhe 23 të Ligjit për Energjinë, me numër 05/L-08, dispozita të cilat, kërkojnë adresimin e çështjes në AKRK, për të shqyrtuar rastin. Pretendimet e ZRRE-së kanë të bëjnë me kriteret e vendosura në ankandin e hapur nga "Ibër Lepenc" SH.A., kritere që sipas ZRRE-së, kanë kufizuar tregun duke ia pamundësuar shumë Operatorëve Ekonomik, pjesëmarrjen në këtë ankand.

TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tregut përkatës Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit – Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike.

Palë në Procedurë:

Palë në procedurë, të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës konsiderohet ndërmarrja: Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A. — Shoqëri Aksionare, me adresë: Prishtinë, 13, Sheshi, Bill Klinton.

Përshkrimi i Gjendjes dhe Aktivitetet e zhvilluara gjatë procedurës hetimore në tregun përkatës

Ndërmarrja Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A. (HC Ujmani), është ndërmarrje publike, me aktivitet ekonomik në prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike, e licencuar nga ZRRE. Ndërmarrja meqë është publike, e ka të obliguar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, që për të gjitha aktivitetet e saja ekonomike të shitblerjes t'i nënshtrohet procedurave sipas ligjeve në fuqi dhe trajtohet si Autoritet Kontraktues.

ZRRE më datë 16.11.2020, ka pranuar në një e-mail zyrtar nga "Ibër Lepenc" SH.A., njoftimin për fillimin e procedurave të ankandit për shitjen e energjisë së prodhuar nga HC Ujmani. Shkresa përmban njoftimin e dërguar nga përfaqësuesi i ndërmarrjes Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., me të cilën ka sqaruar fillimin e procedurave të ankandit për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga "HC Ujmani". E-maili sqaron se duke u bazuar në Ligjin për energjinë elektrike dhe procedurat për tregti me energji elektrike, të hartuara sipas KOSTT-it, ju njoftojmë se më datë 12.11.2020 në web faqen tonë <http://www.iber-lepenc.org> si dhe në gazetën ditore "Epoka e Re" kemi bërë shpalljen për fazën e parë para kualifikuese, afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është data 18.11.2020.

Pas shkresës së dërguar nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., nga përfaqësuesi i ZRRE-së, përmes e-mail i dërgohet shkresë përfaqësuesve të Ndërmarrjes Hidroekonomike, "Ibër Lepenc" SH.A., me të cilën potencohet se:

ZRRE e konfirmon pranimin e njoftimit për fillimin e procedurave, për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga "HC Ujmani", pavarësisht prej afatit të shkurtër kohor në dispozicion, ZRRE-së, ka analizuar shpalljen e interesit të publikuar nga SH.A. Ibër Lepenc", Nr. ILSHEE-20-001, ku janë vërejtur disa mospërputhje më kërkesat ligjore.

Në vijim, ZRRE- potencon se: Dokumenti - procedura e tregtimit të energjisë elektrike që është bazë për mënyrën e prokurimit të energjisë elektrike nuk parasheh kontratën kornizë për tregtimin afatgjatë, dhe po ashtu shpallja që HC Ujmani e ka bërë, nuk është kërkesë për themelimin e kontratës kornizë (siç është në brendësi të dokumentit), por për pjesëmarrje dhe para kualifikim (siç është në titull të dokumentit). Pra derisa procesi është konsideruar si kërkesë për pjesëmarrje në para kualifikim, në brendësi të dokumentit (shpalljes) konsiderohet që nuk i përkasin këtij procesi.

ZRRE shqetësimet e saj i ka ngritur pos tjerash në pikat si në vijim, e për të cilat ka kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës të shqyrtojë tri çështje, që sipas tyre përmbajnë kritere diskriminuese për palët tregtare që veprojnë në të njëjtën fushë me tregtinë me energji elektrike.

Autoriteti, gjatë fazës së monitorimit ka dyshuar në tri çështje, të cilat përmbajnë kritere diskriminuese për palët tregtare, që veprojnë në tregun përkatës:

1. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, ku kërkohet dëshmi nga ofertuesit që pala tregtare, është palë përgjegjëse balancuese, në tregun e energjisë në Kosovë;
2. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike financiare, ku kërkohet që qarkullimi vjetor OE, gjatë tri viteve të fundit ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se ██████████ Euro;
3. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku kërkohet që, Operatori Ekonomik duhet të prezantojë Listën e Referencave të Kontratave të Ekzekutuara me sukses, lidhur me tregtimin e energjisë elektrike gjatë periudhës nga 31.10.2017 deri më 01.01.2020, duke specifikuar emrat e klientëve dhe sasisë me vlerë minimale të barabartë me 225,000 MWh (Megawat për orë).

Ndërmarrja Hidro – ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A, është ndërmarrje publike me aktivitetin ekonomik në prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike, e licencuar nga ZRRE. Ndërmarrja meqë është publike obligohet, me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, që për të gjitha aktivitetet ekonomike të shitblerjes, t'i nënshtrohet procedurave sipas Ligjeve në fuqi dhe e njëjta trajtohet, si Autoritet Kontraktues. Në kuptim të Ligjit 04/L-226 plotësim ndryshimi i Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ndërmarrja Publike, Ibër Lepenc SH.A., trajtohet si ndërmarrje e cila, kryen aktivitet ekonomik, sepse e njëjta është e themeluar sipas, Ligjit 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Andaj, nga sa më lartë, Ligji 04/L-226, plotësim ndryshimi i Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, trajton ndërmarrjet, qoftë ndërmarrje publike, private apo organ shtetëror, atëherë kur angazhohen në aktivitete ekonomike, citojmë, neni 2 paragrafi 2: "Ndërmarrje - çdo aktivitet biznesor, pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktiviteteve për interes publik si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetëror, që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist".

Autoriteti, me datë 23.12.2022 me Nr. Prot 397/22-02/D, ka marrë konkluzion për fillimin e procedurës hetimore ndaj Ndërmarrjes Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se e njëjta ka abuzuar me pozitën dominuese për shkak se:

1. Në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ka vendosur çmimin jo real të blerjes apo shitjes, ose kushte tjera të pa drejta tregtare;
2. Ka kufizuar prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknologjik në dëm të konsumatorëve;
3. Ka zbatuar kushte të ndryshme të transaksioneve për punët e njëjta me ndërmarrjet tjera duke i sjellë ato në një pozitë të pafavorshme në raport me konkurrencën;
4. Ka lidhë kontrata, me kusht që subjektet kontraktuese të pranojnë detyrime shtesë;
5. Ka vendosur çmimet ose kushte tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjen jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre;
6. Ka refuzuar hyrjen një ndërmarrjeje tjetër, duke i dhënë një shpërblim të përshtatshëm në rrjetin ose në infrastrukturën e ndërmarrjes me pozitë dominuese, nëse ky refuzim i përdorimit të rrjetit ose të infrastrukturave, pengon ndërmarrjen tjetër të veprorë si konkurrent i ndërmarrjes me pozitë dominuese.

Autoriteti i Konkurrencës me datën 09.07.2024, Ndërmarrjes Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., i ka dërguar Njoftimin për Konstatimin Paraprak të Fakteve me të cilin ka konstatuar se: Në kriteret e vendosura në shprehjen e interesit për ofertë (ankand publik), nga Ndërmarrja Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A siç janë:

- ✓ Kërkesat e përshtatshme profesionale, ku kërkohet dëshmi nga ofertuesit, që pala tregtare, është palë përgjegjëse balancuese, në tregun e energjisë në Kosovë;
- ✓ Kërkesat mbi gjendjen ekonomike financiare ku kërkohet që, qarkullimi vjetor OE, gjatë tri viteve të fundit ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se [REDACTED] Euro;
- ✓ Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku kërkohet që, Operatori Ekonomik duhet të prezantojë Listën e Referencave të Kontratave të Ekzekutuara me sukses, lidhur me tregtimin e energjisë elektrike gjatë periudhës nga 31.10.2017 deri më 01.11.2020, duke specifikuar emrat e klientëve dhe sasitë me vlerë minimale të barabartë me 225000 Mwh (Megawat për orë).

Ka vendosur kushte të pafavorshme për ndërmarrjet në tregun përkatës, ndërsa është favorizuar ndërmarrja Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K., me ç'rast ka shkaktuar pasojë në dëm të konkurrentëve dhe interesit të përgjithshëm, ngase sjelljet e tilla përbëjnë kufizime të konkurrencës me rastin e shpalljes së Shprehjes së Interesit (ofertimit), për shitjen e energjisë elektrike përmes procedurave jo të njohura, duke mos përfillur kornizën ligjore me ç'rast ka shkaktuar diskriminim në vendosjen e kushteve dhe kriterëve për aplikim dhe favorizim të kompanisë, e cila është shpërblyer me kontratë.

Veprimet apo sjelljet e tilla, për më shumë, hapja e ankandëve të shitjes së energjisë elektrike nga NH "Ibër Lepenc" SH.A., pa bazë të qartë ligjore, pa konkurrencë, duke paraqitur kushte e kriteret e cilat qartazi duken se janë kufizuese për konkurrentët tjerë dhe favorizuese për kompaninë fituese.

Kriteret e potencuara, janë vendosur në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Abuzimi me Pozitën Dominuese, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.5, me të cilin potencohet se: Abuzimi me pozitën dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant është i ndaluar veçanërisht nëse:

- në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë vendos çmimin jo real të blerjes apo shitjes, *ose kushte tjera të pa drejta tregtare*; si dhe:
- vendosja e çmimeve *ose e kushteve tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjen jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre*;

Ndërmarrja NH "Ibër Lepenc" SH.A, brenda afatit ligjor, më datë 09.08.2024, me Nr. Prot 510/24-01/H, në Autoritet ka dërguar komentet dhe vërejtjet në lidhje me Njoftimin e Fakteve Paraprake të Konstatuara në Procedurë, në komentet e dërguara ndërmarrja i ka pranuar të gjitha të gjeturat e Autoritetit, përveç kundërshtimi se Ndërmarrja NH "Ibër Lepenc" SH.A, nuk ka pozitë dominuese me arsyetimin se: pjesëmarrja e ndërmarrjes në treg të Kosovës, bazuar në raportin vjetor të ZRRE-së është afër 3% të prodhimit total në Kosovë.

Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar komentet e datës 09.08.2024 të Ndërmarrjes NH "Ibër-Lepenc" SH.A, lidhur me kundërshtimin e pozitës dominuese. Autoriteti bazuar nga të dhënat e siguruar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Ndërmarrja NH "Ibër Lepenc" SH.A, në prodhimin e BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2021 ka qenë 297,41 GWH, ka prodhuar 109.44 GWH. Bazuar në nenin 6, të Ligjit Nr.04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërmarrja për vitin 2021 ka pozitë dominuese 36.80%.

Pra, tregu i produktit është prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike, përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike.

Po ashtu, Autoriteti me datën 14.08.2024, me Nr. prot. 526/24-01/H, ka pranuar shkresën e ndërmarrjes Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k. në të cilën është potencuar se:

Pa e paragjykuar vendimin përfundimtar të AK, duam të tërheqim vëmendjen tuaj ndaj të paktën dy vendimeve në raste të tjera që vetë AK ka nxjerrë, respektivisht Konkluzionin Nr. 56/2022 të Autoriteti me datën 14.08.2024, dhe Konkluzionin 54/2022 të datës 25.11.2022. Në të dyja vendimet AK e thotë qartazi se kriteret e tenderit, vendosen nga Autoriteti Kontraktues dhe se të tillat nuk janë objekt i veprimtarisë së AKI përkatësisht thotë se "kushtet e hapjes së tenderit, të cilat në thelb kanë të bëjnë më të drejtën për të marrë pjesë, përkatësisht me kushtet e aftësisë së konkurrentëve, zbatimi dhe interpretimi i të cilave nuk është brenda kompetencës dhe fushëveprimit të Autoritetit Kontraktues, është çështje e mbikëqyrjes në kompetencë të organeve të administratës shtetërore/qendrore bazuar në rregullore të veçanta që rregullojnë një çështje të caktuar.

Autoriteti me datën 15.10.2024, i ka dërguar shkresë ndërmarrjes, Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k. me të cilin ka sqaruar se:

Autoriteti i Konkurrencës në dy rastet e potencuara nga ndërmarrja Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k., fillimisht është analizuar sjellja e organeve publike në cilësinë e autoriteteve kontraktuese në lidhjen e kontratave publike administrative, veprimi i parë që është ndërmarrë nga Autoriteti, është vërtetuar nëse këto organe publike veprojnë apo jo si ndërmarrje në kuptim të paragrafit 10 dhe 12 të nenit 3 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke monitoruar nëse këto organe publike, autoritete kontraktuese, për tregun përkatës në të

cilën kanë lidhur kontrata, janë ose jo të angazhuar në një veprimtari ekonomike. Autoriteti i Konkurrencës pas monitorimit të tregut lidhur me dy konkluzionet e potencuara, Komunitat në rastin konkret nuk i ka konsideruar ndërmarrje, pasi të njëjtat nuk kanë kryer aktivitet ekonomik dhe si rrjedhojë nuk kanë operuar në treg.

Ndërmarrja "Ibër Lepenc" SH.A., është Ndërmarrje Publike Qendrore e cila vepron sipas Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, e regjistruar pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve pranë Ministrisë së Industrisë Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, ashtu siç parashihet me Ligjin Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, e cila kryen aktivitet ekonomik dhe si e tillë trajtohet sipas paragrafit 10 dhe 12 të nenit 3 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti pas analizimit të komenteve të Ndërmarrjes NH "Ibër Lepenc" SH.A, në bazë të të cilave konstaton se, nuk kishte fakte ose prova të reja të cilat e ndryshojnë gjendjen faktike. Me datën 15.10.2024 Ndërmarrjes Hidro - ekonomike "Ibër Lepenc" SH.A. i ka dërguar Njoftimin e Fakteve të Konstatuara në Procedurë së bashku me ftesën për seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore është mbajtur më 29.10.2024, ku janë diskutuar dhe analizuar të gjitha provat dhe pretendimet nga pjesëmarrësit.

Të gjeturat dhe Analiza e konkurrencës

Autoriteti, pas analizimit të kërkesës së datës, 28.02.2022 me Nr. protokollit 71/22-01/H, nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, e cila ka kërkuar nga AKRK që të vlerësojë çështjet e konkurrencës përkitazi me Kontratën 01-2986, të datës 21.12.2020, e lidhur ndërmjet Ndërmarrjes NH "Ibër Lepenc" SH.A. dhe Kompanisë "Future Energy Trading and Exchange Dynamics" SH.P.K, me Pretendimin se kriteret e vendosura në ankandin e hapur nga ndërmarrja "Ibër Lepenc" SH.A, janë kritere që kufizojnë tregun, për shkak se ua kanë pamundësuar shumë Operatorëve Ekonomik pjesëmarrjen në këtë ankand.

Autoriteti bazuar nga të dhënat e siguruar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, ka konstatuar se Ndërmarrja "Ibër Lepenc" SH.A., në prodhimin e BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2021, në bazë të nenit 6, të Ligjit Nr.04-L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka pozitë dominuese 36.80%.

Bazuar në neni 6, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, përcaktimi i pozitës dominuese ka qenë 25%.

Po ashtu, pas vlerësimit të të dhënave, Autoriteti konstaton se kriteret e vendosura në shprehjen e interesit për ofertë (ankand publik), nga Ndërmarrja NH "Ibër Lepenc" SH.A., siç janë:

- ✓ Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, ku kërkohet dëshmi nga ofertuesit, që pala tregtare, është palë përgjegjëse balancuese, në tregun e energjisë në Kosovë";
- ✓ Kërkesat mbi gjendjen ekonomike financiare ku kërkohet që, qarkullimi vjetor OE, gjatë tri viteve të fundit ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 7,940,250.00 Euro;
- ✓ Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku kërkohet që, Operatori Ekonomik duhet të prezantojë Listën e Referencave të Kontratave të Ekzekutuara me sukses, lidhur me tregtimin e energjisë elektrike gjatë periodës nga 31.10.2017 deri më

01.11.2020, duke specifikuar emrat e klientëve dhe sasi të me vlerë minimale të barabartë me 225000 MWH (Megawat për orë).

Janë vendosur në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Abuzimi me Pozitën Dominuese, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.5, me të cilin potencohet se: Abuzimi me pozitën dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant është i ndaluar veçanërisht nëse:

- në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë vendosë çmimin jo real të blerjes apo shitjes, *ose kushte tjera të pa drejta tregtare*; si dhe:
- vendosja e çmimeve *ose e kushteve tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjen jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre.*

Në vazhdim, sjellja e ndërmarrjes në këtë rast ka dëmtuar konkurrencën në treg, duke vendosur kushte të pafavorshme për ndërmarrjet tjera në tregun përkatës, ndërsa është favorizuar ndërmarrja Future Energy Trading and Exchange Dynamics Sh.p.k, me ç'rast ka shkaktuar pasoja në dëm të konkurrentëve dhe interesit të përgjithshëm, ngase sjelljet e tilla përbëjnë kufizime të konkurrencës duke vendosur kushte të pa drejta për hyrje në treg, për shkak se me vendosjen e kushteve jo konkurruese apo përjashtuese, nuk kanë pasur mundësi të hyjnë ndërmarrjet e tjera në treg. Pra, nuk është ruajtur procesi konkurrues efektiv. Ndërmarrja me pozitë dominuese ka përjashtuar një pjesë të ndërmarrjeve në tregun relevant që kanë pasur mundësi t'i qasen tregut, të cilat kanë qenë të licencuara për kryerjen e këtij aktiviteti. Sjellja e ndërmarrjes "Ibër Lepenc" SH.A., ka qenë në fuqi për një periudhë të mjaftueshme kohore, dëshmi të drejtpërdrejtë të një përjashtimi anti-konkurrues, pasi që me veprimet e tilla konkurrentët aktualë ose të mundshëm janë penguar për të hyrë në treg.

Të gjithë pjesëmarrësit në treg të cilët janë të licencuar në Republikën e Kosovës dhe të licencuara jashtë vendit por që njihen reciprokisht, duhet pasur mundësinë të marrin pjesë në aktivitetet e shitblerjes së energjisë elektrike, duke ju siguruar një ambient konkurrues dhe jo diskriminues.

Ligji dhe procedurat për tregtimin e energjisë elektrike nuk i kufizon pjesëmarrësit në asnjë aktivitet të shitblerjes së energjisë elektrike, në atë se a duhet të jenë balancues në tregun e energjisë elektrike, pra nuk parashihet që një pjesëmarrësi në treg t'i kufizohet pjesëmarrja në një aktivitet shitblerjeje të energjisë elektrike, duke i kërkuar që tri vitet e fundit të ketë marrë pjesë në aktivitete të shitblerjes së energjisë elektrike, duke paraqitur shuma në mjete monetare dhe fuqi të MW të tregtuar.

Kalkulimi i Gjobës dhe Mënyra e Shqiptimit

Autoriteti ka konstatuar se periudha e keqpërdorimi i pozitës dominuese, është nga viti 2021 deri më 2023. Andaj në mbështetje të nenit 56 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 si dhe nenit 59 paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti kalkulimin e gjobës e ka përllogaritur në këtë mënyrë:

Qarkullimi i Ndërmarrjes "Ibër Lepenc" SH.A, në tregun përkatës nga viti 2021 deri në vitin 2023, ishte [REDACTED]

Shuma e kontratës është [redacted] e cila është shumëzuar me 30%, baza e ndëshkimit është [redacted] e cila është shumëzuar me [redacted] e vlerës së mbetur.

Autoriteti aplikoi normën [redacted] të bazës së ndëshkimit 30%, sipas kontratës e cila ishte [redacted]

Autoriteti ka vlerësuar si një rrethanë lehtësuese, faktin se pala ka bashkëpunuar me Autoritetin gjatë procedurave dhe se pala nuk ishte ndëshkuar më parë për ndonjë formë të çrregullimit të konkurrencës.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 54, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela

Nënkryetare

Nafije Osdautaj

Anëtare

Florant Mehmeti

Anëtar

Salihe Gashi Loku

Anëtare


Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë VENDIM të njoftohen:

- Ndërmarrja "Ibër Lepenc" SH.A
- Zyra e Rregullatorit për Energji
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Më, 22.01.2025

Mendimi i Kryetares së Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës

Në cilësinë e Kryetares të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, dua të theksoj rëndësinë e mbrojtjes së konkurrencës së ndershme në tregjet e Kosovës dhe angazhimin tonë për të siguruar që të gjitha ndërmarrjet të veprojnë brenda kuadrit ligjor dhe politikave të konkurrencës. Vendimi nr. K-04/25 i datës 09.01.2025, i Komisionit në lidhje me Ndërmarrjen Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., është një hap i rëndësishëm për adresimin e praktikave të abuzimit me pozitat dominuese në tregun energjetik.

Sipas vendimit të Komisionit, është konstatuar se Ndërmarrja "Ibër Lepenc" ka pasur një pozicion dominues në tregun e energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme dhe ka abuzuar me këtë pozicion, duke shkaktuar dëme të mëdha për konkurrencën dhe interesin publik. Kjo sjellje është qartazi në shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe ka një ndikim negativ në lirinë e konkurrencës, që është një nga shtyllat kryesore të një ekonomie me treg të lirë.

Si pjesë e këtij vendimi, është vendosur një masë ndëshkuese administrative për Ndërmarrjen, duke i shqiptuar një gjobë të konsiderueshme. Kjo masë është një paralajmërim për çdo ndërmarrje tjetër që mund të tentojë të përdorë pozitat e saj dominuese për të shkelur ligjin dhe për të dëmtuar konkurrencën.

Megjithatë, dua të theksoj se ky vendim është vetëm një pjesë e procesit. Si Kryetare e Komisionit, mendoj se është e domosdoshme që përgjegjësia për këtë abuzim të adresohet dhe të shqyrtohet gjithashtu në nivelin e ish-menaxhmentit të ndërmarrjes, Bordit dhe Kryeshefit. Kjo kontratë ishte nënshkruar nga menaxhmenti i kaluar me aprovimin e Bordit të Drejtorëve, në përbërje të znj. Marigona Hamdija (kryesuese), znj. Afërdita Llumica, z. Enver Rrustemi, dhe z. Dejan Radajkovic (anëtarë të Bordit), të cilët përmes procesverbalit të mbledhjes së datës 16.12.2020, me nr. 08-176, të datës 29.01.2021, kishin aprovuar kontratën, të cilën e ka nënshkruar z. Berat Lushtaku, si Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes.

Ky është një moment i rëndësishëm për të vlerësuar përgjegjësinë e individëve që kanë marrë vendime, të cilat kanë dëmtuar interesat e publikut dhe të Ndërmarrjes "Ibër Lepenc". Kjo çështje duhet të shqyrtohet me kujdes nga organet kompetente të hetuesisë, të cilat duhet të sigurojnë që përgjegjësit të mbajnë llogari për veprimet e tyre.

Në përfundim, ky vendim i Komisionit është një hap i rëndësishëm në forcimin e konkurrencës dhe në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe të ekonomisë në përgjithësi. Ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim dhe transparencë për të siguruar që tregu të funksionojë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aktorët ekonomikë.

Me respekt!

Melme Binaku Isufi
Kryetare

Autoriteti i Konkurrencës
Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra nr. 601
Tel: +383/0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net